

V E N D I M
Nr.70, datë 10.3.2003

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR SHQYRTIMIN E
LIGJSHMËRISË SË PËRDORIMIT TË FONDEVE PUBLIKE DHE TË ARDHURAVE TË
TJERA NË MINISTRINË E KULTURËS DHE BASHKINË E TIRANËS PËR PERIUDHËN
1992-2002, SI DHE ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË PËR ZHVILLIMIN URBANISTIK NË
TIRANË PËR PERIUDHËN 1992-2002**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Ngrihet komisioni hetimor i Kuvendit:

a) për të shqyrtuar ligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike dhe të ardhurave të tjera në Ministrinë e Kulturës dhe Bashkinë e Tiranës për periudhën 1992-2002;

b) për të shqyrtuar zbatimin e ligjshmërisë në zhvillimin urbanistik për qytetin e Tiranës për periudhën 1992-2002.

II. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 anëtarë nga pozita dhe 5 anëtarë nga opozita.

III. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej 3 muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

IV. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Servet Pëllumbi